



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1126 Prot.

Tiranë, më datë 16.09.2022

VENDIM

Nr. 461, datë 16.09.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.09.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID në Parkun Arkeologjik të Durrësit”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "A" dhe Park Arkeologjik, me aplikues Illyrian Consulting Engineers dhe zhvillues Bashkia Durrës;
2. Miratimin e Konceptit të Sondazheve Arkeologjike, hartuar nga subjekt i licencuar Z. Luan Përzhita;
3. Zhvilluesi duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për kryerjen e sondazheve arkeologjike;
4. Rezultatet e sondazheve arkeologjike, do të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në mbledhjen e KKTKM-së;
5. Punimet për infrastrukturën nëntokësore, të parashikuara në projekt, duhet të shoqërohen me një program monitorimi arkeologjik dhe dokumentimi stratigrafik nga subjekt i licencuar në arkeologji. Raportet e monitorimit arkeologjik dhe dokumentimit të depozitohen pranë IKTK;
6. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

